

Njoftim për Përditësimin e të Dhënave Personale

Në zbatim të ligjit nr. 124/2024, datë 19.12.2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", kuadrit rregullator të Bankës së Shqipërisë, si dhe të politikave të brendshme të institucionit tonë për identifikimin, verifikimin dhe përditësimin periodik të të dhënave të klientëve, ju informojmë se është e nevojshme të kryeni përditësimin e të dhënave tuaja personale pranë bankës.

Gjithashtu, përditësimi i të dhënave duhet të kryhet edhe për zbatim të Standardit të Përbashkët të Raportimit për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarisë Financiare (CRS), parashikuar në dispozitat e ligjit nr. 4/2020 "Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarisë financiare", dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 613 datë 29.07.2020 "Mbi Dispozitat Implementuese të Ligjit Nr. 4/2020", i cili ka për qëllim reduktimin e evazionit fiskal që del jashtë kufijve të juridiksioneve pjesëmarrëse.

Ky proces është i detyrueshëm dhe ka për qëllim:

- Zbatimin e detyrimeve ligjore e rregullatore .
- Për të mundësuar një identifikim të sakte të klientit.
- Për të mundësuar një komunikim të vazhdueshëm me bankën.
- Sigurimin e aksesit të klientit për njoftime të rëndësishme.
- Ruajtjen e integritetit të marrëdhënies kontraktore ndërmjet klientit dhe bankës.
- Përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara ndaj klientëve.
- Sigurimin e përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Të dhënat që duhet të përditësohen përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- Dokument identifikimi të vlefshëm (ID / Pasaportë);
- Adresë banimi;
- Numër telefoni dhe adresë elektronike;
- Të dhëna të tjera financiare ose të kontaktit, sipas rastit.

Afati për përditësim:

Rekomandohet të kryeni konfirmim ose përditësim të të dhënave të deklaruara në bankë minimalisht një herë në vit, gjithashtu sa herë do të keni ndryshime në të dhënat tuaja personale..

Mënyrat e përditësimit:

- Nëpërmjet paraqitjes fizikisht në degë, me dokument identifikimi të vlefshëm.

Mbledhja, përpunimi dhe transferimi i këtyre të dhënave nga Banka e Bashkuar e Shqipërisë do të kryhet në përputhje me ligjin nr. nr. 124/2024, datë 19.12.2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" dhe udhëzimin e Bankës së Shqipërisë, nr. 32, datë 08.05.2002 "Për sekretin bankar".